

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6384
E mërkurë, 11 gusht 2021
çmimi 0.40 €

Murati: Regjistrimi i popullsisë i vitit 2022 do të jetë më cilësor dhe më i sigurt



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INSTITUCIONET E KOSOVËS NDIHMOJNË AUTORITETET E SHQIPËRISË PËR SHUARJEN E ZJARREVE

KOSOVA SËRISH I GJENDET PRANË SHQIPËRISË



Kosova edhe një herë i ka dalë në ndihmë Shqipërisë. Pas përhapjes së zjarreve në Qarkun e Kukësit, institucionet e Kosovës me shpejtësi i janë përgjigjur pozitivisht kërkesës së

autoriteteve shqiptare për luftimin e zjarreve. Një kontingjent i FSK-së dhe 33 zjarrfikës të martën kanë filluar angazhimin për shuarjen dhe vënien në kontroll të zjarreve në

njësinë administrative Malzi. Autoritetet më të larta të Shqipërisë kanë falënderuar Kosovën për mbështetjen në për tejkalimin e kësaj sfide

Varianti 'Delta' po përhapet me shpejtësi edhe në Kosovë



Dy viktima nga Covid-19 janë regjistruar gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë. Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të martën edhe 562 raste të reja me Covid. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, pas rezultateve të së martës, ka theksuar se varianti 'Delta' po përhapet me shpejtësi dhe numri i rasteve po rritet. Ky institut ka përsëritur thirrjen për vaksinim

Ministrja Hajdari merr vendim që të hetohet importi i blloqeve nga Serbia



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht--Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

OPINION

"BALLKANI I HAPUR", RRUGA E TË ARDHMËS

Shkruan: Edi RAMA,
kryeministër i
Shqipërisë



AKTUALE



HAZIRI: 163 FAMILJE GJILANASE I KEMI BËRË ME KULM MBI KOKË

VUÇIQI: NJOHJA E KOSOVËS NGA IZRAELI ISHTE ZHGËNJYESE PËR SERBINË

EKONOMI

RUKIQI TAKOHET ME NËNKRYETARIN E ODËS EKONOMIKE TË IZRAELIT, ZOTOHEN PËR BASHKËPUNIM



SPORT

PRISHTINA TRANSFERON BETIM HALIMIN

ZYRTARIZOHET MARRËVESHJA E SPONSORIZIMIT E LIGËS SË PARË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja ndihmon Mianmarin me mbi 50 milionë dollarë



WASHINGTON, 10 GUSHT- - Shtetet e Bashkuara njoftuan të martën se do ta ndihmojnë Mianmarin (i njohur edhe si Burma) me më shumë se 50 milionë dollarë për të zbutur një krizë humanitare që u shkaktoi nga trazirat politike dhe nga rritja e numrit të të infektuarve me Covid-19.

Ky vend i Azisë Juglindore është përfshirë në trazira, tash e sa kohë, pasi në muajin shkurt ushtria rrëzoi një qeveri të zgjedhur në mënyrë demokratike dhe mori pushtetin me dhunë.

ShBA-ja, gjithashtu, ka ndarë një ndihmë prej 5 milionë dollarësh për Tajlandën për ta përballuar situatën me pandeminë, ka pohuar zëdhënësi i Departamentit të Shtetit të ShBA-së, Ned Price, përmes një deklaratë.

Në Mianmar mjetet financiare amerikane do të ofrojnë ndihmë për “njerëzit që detyrohen të largohen nga dhuna dhe

persekutimi, si dhe personat që ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor”, ka njoftuar Departamenti i Shtetit. “Ky financim vjen në një kohë kritike pas rritjes së nevojave humanitare dhe do të ndihmojë në zbutjen e ndikimeve të Covid-19 në jetën e njerëzve të Tajlandës dhe Burmës”, ka thënë Price.

Pas grushtit të shtetit të 1 shkurtit, njerëzit nga Mianmar vazhdojnë të largohen nga shtëpitë e tyre për shkak të dhunës së vazhdueshme. Gjashtë muaj pasi ushtria mori pushtetin, ekonomia dhe sistemi shëndetësor i Mianmarit janë goditur rëndë.

Rastet me Covid-19 arritën kulmin në Mianmar muajin e kaluar, me 3 824 raste të reja ditore. Në këtë vend janë shënuar 12 014 vdekje të lidhura me koronavirusin që nga fillimi i pandemisë.

Në Tajlandë raportohen më shumë se 20 400 raste çdo ditë, sipas të dhënave të “Reuters”.

Polonia dhe Letonia përballen me fluks migrantësh nga Bjellorusia

MINSK, 10 GUSHT- Polonia dhe Letonia kanë regjistruar numër rekord të migrantëve që kanë kaluar përmes kufijve të tyre me Bjellorusinë, teksa shtohen akuzat se Minsku është duke përdorur migrantët si armë kundër Bashkimit Evropian.

Në javët e fundit Lituania është përballur me valë migrantësh, kryesisht irakianë- nga Bjellorusia, duke nxitur autoritetet në këtë vend, anëtare të BE-së, që t'i ashpësojnë kalimet kufitare dhe t'i kthejnë mbarsht migrantët.

Ndërkohë që Lituania ka ashpërsuar kalimet kufitare, Polonia dhe Letonia tani janë duke akuzuar Bjellorusinë për rritje të numrit të migrantëve nëpër kufijtë e tyre.

Garda Kufitare në Poloni ka bërë me dije, në një deklaratë më 9 gusht, se ka ndaluar 359 migrantë ilegalë në kufi me Bjellorusinë nga 6 gushti. Sipas saj, migrantët kanë qenë nga Iraku apo Afganistani.

Më 2020 Garda Kufitare polake ka ndaluar 122 migrantë të paligjshëm në kufi me Bjellorusinë, ndërsa këtë vit numri është rritur në gati 900.

Polonia, shtetet baltike dhe zyrtarë të BE-së besojnë se vala e migrantëve është duke u orkestruar nga lideri autoritar në Bjellorusi,

Alyksandr Lukashenka, si hakmarrje ndaj sanksioneve të bllokut evropian ndaj qeverisë së tij për shkak të shtypjes së protestave pro-demokracisë nga gushti i vitit të kaluar.



Kryeministri grek kërkon falje për situatën e shkaktuar nga zjarret



Kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis ka kërkuar falje për dështim në luftën me zjarret pyjore në këtë shtet. Qindra zjarrfikës kanë luftuar me zjarret të cilat kanë shtyrë mijëra persona të ikin nga shtëpitë e tyre, si dhe kanë shkatërruar dhjetëra prona. “Ne mund të kemi bërë çfarë ka qenë e mundshme nga ana njerëzore, mirëpo në disa

raste nuk ka qenë mjaftueshëm”, ka thënë Mitsotakis.

Tymi i dendur është duke u parë ende në Ishullin Evia, në verilindje të Athinës, që ka shkaktuar zjarret tash e një javë.

Dhjetëra shtëpi dhe hektarë pyje janë shkatërruar në zonën Evia.

Zemërimi publik është rritur

në këtë shtet për shkak të përgjigjes qeveritare si dhe mungesës së pajisjeve adekuate për shuarje të zjarreve.

Mitsotakis ka thënë se “secili dështim potencial do të identifikohet”, ndonëse ka insistuar se zjarrfikësit kanë qenë në betejë me “fuqi natyrore që tejkalojnë fuqitë e tyre”.

“Ballkani i hapur”, rruga e të ardhmes



Shkruan: Edi RAMA,
kryeministër i
Shqipërisë

Dje pata kënaqësinë e posaçme të kem për vizitë nga Kosova dy vajzat e arta shqiptare të Tokios, së bashku me trajnerin e tyre fenomenal. Kërkuam të më takonin dhe u ndjeva shumë i nderuar. Biseda me vajzat e me trajnerin dhe miqtë që i shoqëronin ishte frymëzuese dhe me disa ide të bukura bashkëpunimi që u pajtuam t'i zhvillojmë së bashku. Kur kërkuam të dilnim edhe në fotografi, u thashë: “Po unë jam tradhtar, s'dua t'ju hap telashe!”. Qeshën shumë në fakt dhe i bëmë fotografitë që kishin dëshirë edhe t'i publikoja në faqen time. Mirëpo, siç e prisja, ushtria digjitale e, kinse patriotëve matanë kufirit, që të sharat e

mallkimet i kanë armët e tyre të luftës qorre të shqiptarit me shqiptarin dhe që s'po dinë hiç çka t'i bëjnë gomarit e po i bien samarit, u lëshua uturishëm në lumin e komenteve të postimit tim. Fali Zot se s'dinë se ç'bëjnë, është më e mira që duhet thënë në këto raste. Dhe falur i kam, ata e kë ata i frymëzoi e i ushqen me helmin verbues të urrejtjes, dasisë, frikës nga e ardhmja. Por dy fjalë sa më shkurt për një bisedë kaq të gjatë, s'po i lë pa thënë me këtë rast.

Koha nuk ndalet dhe paqja nuk fitohet me mjetet e luftës. Kosova e fitoi luftën falë aleancës së pathyeshme të Shteteve të Bashkuara me fuqitë më të mëdha evropiane, në mbështetje të ushtrisë së saj çlirimtare. Pa atë aleancë as liria, as shtetësia, as paqja për popullin e Kosovës nuk do të kishte ardhur dot sot e gjithë ditën.

Po a mund ta fitojë Kosova paqen përfundimtare dhe a mund të prosperojë kombi shqiptar, duke u ftohur e siç i themi ne, duke “i treguar babait arat”, kur flet me Amerikën, Gjermaninë, Francën a me vetë Bashkimin Evropian?

E bëj këtë pyetje, sepse e kam jetuar në vetë të parë “tregimin e arave”, deri në pikën që një lider kosovar ia futi në sy të Merkelit e Macronit, “mu nuk më han luli për këta!” dhe mu aty e humbi rastin historik t'ia hiqte vizat Kosovës, të cilën e bëri lolo në sytë e aleatëve të saj të pazëvendësueshëm strategjikë me marrëzira kinse patriotike.

A mund ta fitojë Kosova paqen dhe a mund të lulëzojë shteti i saj i ri, po edhe shqiptaria si e tërë, duke e kthyer dialogun me Serbinë në një monolog që nuk i prish asnjë punë Serbisë (përkundrazi acaroi prej vitësh tanimë nervat e aleatëve tanë të pazëvendësueshëm strategjikë, të cilëve për krejt fajin e monologuesve të Kosovës, Serbia u duket gjithnjë e më e pafajshme, ndërsa Kosova gjithnjë e më pak e arsyeshme)? E bëj këtë pyetje, sepse prej tetë vjetësh tanimë e dëshmoj në vetë të parë, trajektoren gjithnjë e më në rënie të respektit e të durimit të tyre me Prishtinën zyrtare dhe më dhembin gjithnjë e më shumë shtrëmbërimet e buzëve të tyre, kur flitet për Kosovën.

A mund të zgjidhet çështja e madhe e njohjes së Kosovës nga

Serbia, duke e thelluar më tutje deformimin e madh disaveçar tashmë në Kosovë, të bërjes së politikës së brendshme të Prishtinës politikë të jashtme të Kosovës dhe anasjelltas, si edhe duke e futur në shabllonin vulgar të tradhtisë dhe vetë politikën e re rajonale të Tiranës zyrtare?

E bëj këtë pyetje këtu, për t'iu thënë të gjithë atyre në Kosovë që e kanë gjetur tradhtarin tek unë se, së pari, unë jam po ai që në mes të Beogradit fola me zë të lartë për njohjen e Kosovës nga Serbia dhe sikur të tërë ta mbronin njohjen e Kosovës në gjuhë të huaj të paktën siç e mbroj unë, kudo e kurdoherë, sot Kosova do të ishte shumë më e respektuar ndërkombëtarisht. Së dyti, “Ballkani i hapur” është jo vetëm rruga e të ardhmes për prosperitetin e kombit shqiptar, si komb evropian që përkatësinë e vet e ka në Evropën e Bashkuar, por është edhe një mundësi e re dhe e madhe më shumë, në rrugën drejt njohjes së Kosovës nga Serbia; sa për një nga shumë shembuj të dobisë së madhe të “Ballkanit të hapur”, kush nuk do që ta kuptojë pse “Ballkani i hapur” e heq më në fund kufirin mes Shqipërisë e

Kosovës, le të më thotë pse nuk e kanë hequr dot deri më sot ata që e kanë premtuar me bujë dhe pse nuk e heq dot pa “Ballkanin e hapur” atë kufi, asnjë prej atyre të cilëve “nuk u han luli” për aleatët e pazëvendësueshëm strategjikë të Kosovës e të Shqipërisë bashkë, që e mbështetin plotësisht nismën “Open Balkan”.

Dhe, së fundi, kush në Kosovë mendon se duke më sharë e mallkuar mua e bën Kosovën më të fortë në luftën diplomatike për njohjen nga Serbia, pushka top le t'i bëhet, e ka të gjithë bekimin tim të nxjerrë krejt gjuhën jashtë. Por ama askush në Kosovë a në Shqipëri qoftë, të mos presë assesi që unë dhe shumica e re qeverisëse e Shqipërisë, të heqim dorë nga lufta diplomatike për paqe e prosperitet ekonomik e social në “Ballkanin e hapur” - përfshirë edhe njohjen e Kosovës nga Serbia. E cila bëhet me mend, krah për krah me aleatët e pazëvendësueshëm strategjikë të Shqipërisë e të Kosovës, e jo me “lulin” e kinse patriotizmit digjital. Koha do të flasë më shumë e më mirë!

DY VIKTIMA DHE 562 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

Varianti ‘Delta’ po përhapet me shpejtësi edhe në Kosovë

Dy viktima nga Covid-19 janë regjistruar gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë. Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të martën edhe 562 raste të reja me Covid. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, pas rezultateve të së martës, ka theksuar se varianti ‘Delta’ po përhapet me shpejtësi dhe numri i rasteve po rritet. Ky institut ka përsëritur thirrjen për vaksinim

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 GUSHT- Dy viktima nga Covid-19 janë regjistruar gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë. Të vdekurit janë njëri nga Prizreni, tjetri nga Rahoveci. Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të martën edhe 562 raste të reja me Covid. Shifra bazohet në 5 272 mostra të testuara. Në përqindje, 10.6 e të testuarve kanë dalë pozitivë. Më së shumti të infektuar janë regjistruar në Prishtinë, 100, pasuar nga Klina me 46 dhe Gjilani me 44 të infektuar. Pjesa më e madhe e të infektuarve

janë të moshave nga 20 deri në 29 vjeç, përkatësisht 164 persona.

Në njoftim thuhet se janë shëruar 78 pacientë nga sëmundja Covid-19, ndërsa raste aktive janë 2 640.

Prej 13 marsit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 110 756 pacientë me këtë virus. Prej këtyre 2 273 kanë vdekur.

Në Kosovë tashmë ka nisur programi i vaksinimit masiv kundër koronavirusit.

Në këtë vend ka vaksina të prodhuesve “Pfizer/BioNTech” dhe “AstraZeneca”.



Përgjatë së hënës ndonjëren nga këto vaksina e kanë marrë 17 085 persona.

Numri i personave të vaksinuar me të dyja dozat e vaksinave ka shkuar në 170 852, ndërsa shifra totale e vaksinave të dhëna është 504 817.

Instituti Kombëtar i

Shëndetësisë Publike i Kosovës, pas rezultateve të së martës, ka theksuar se varianti ‘Delta’ po përhapet me shpejtësi dhe numri i rasteve po rritet. IKShPK-ja ka përsëritur thirrjen për vaksinim. “Nëse nuk vaksinohehi mund të rriten

rastet e reja duke u përcjellë me shtim të hospitalizimeve, vdekjeve, mbingarkesë të sistemit shëndetësor, rikthim të kufizimeve, goditje të shëndetit mental, shkollës, ekonomisë, kulturës, artit e sportit”, është bërë me dije në njoftimin e IKShPK-së.



INSTITUCIONET E KOSOVËS NDIHMOJNË AUTORITETET E SHQIPËRISË PËR SHUARJEN E ZJARREVE

Kosova sërish i gjendet pranë Shqipërisë

Kosova edhe një herë i ka dalë në ndihmë Shqipërisë. Pas përhapjes së zjarreve në Qarkun e Kukësit, institucionet e Kosovës i janë përgjigjur pozitivisht kërkesës së autoriteteve shqiptare për shuarjen e zjarreve. Një kontingjent i FSK-së dhe 33 zjarrfikës të martën kanë filluar angazhimin për shuarjen dhe vënien në kontroll të zjarreve në njësinë administrative Malzi. Autoritetet më të larta të Shqipërisë kanë falënderuar Kosovën për mbështetjen për tejkalimin e kësaj sfide

EPOKA ERE

Muhamet KOÇI

Prishtinë, 10 gusht - Pas përhapjes së zjarreve në Qarkun e Kukësit, institucionet e Kosovës me shpejtësi kanë mobilizuar trupat për t'iu përgjigjur pozitivisht kërkesës së autoriteteve shqiptare në luftimin e zjarreve. Brenda pak ore kontingjenti i FSK-së dhe 33 zjarrfikës me dhjetë automjete për luftimin e zjarreve malore janë nisur për në Shqipëri dhe të martën kanë filluar angazhimin në Qarkun e Kukësit për t'i mbështetur autoritetet shqiptare për shuarjen dhe vënien në kontroll të zjarreve.

Pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për t'i ofruar ndihmë Republikës së Shqipërisë për shuarjen e zjarreve, presidentja Vjosa Osmani, në cilësinë e komandantes supreme, në pajtim me kompetencat e saj, ka nënshkruar autorizimin për dërgimin e trupave dhe

pajisjeve të FSK-së në operacion humanitar dhe në të njëjtën kohë e ka informuar për këtë veprim Kuvendin e Kosovës. "Trupat dhe pajisjet FSK-së do t'u vihen në dispozicion autoriteteve shqiptare me qëllim të shuarjes dhe vënies në kontroll të zjarreve", është thënë në njoftimin e presidencës.

Më pas, ministrit e linjës kanë mobilizuar dhe nisur trupat për në Shqipëri.

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka deklaruar se që prej fillimit të shpërthimit të zjarreve, krahas operacioneve në vend, FSK-ja ka ofruar mbështetjen e plotë me kapacitetet në dispozicion në mbështetje të autoriteteve shqiptare. "Pas rëndimit të situatës, përveç në zonat jugore, tanimë edhe në ato veriore, dhe kërkesës së autoriteteve shqiptare për mbështetje, kam siguruar homologun tim, ministrin Peleshi, se vullneti im për


zbarkim të kontingjentit të FSK-së në operacion për shuarjen e zjarreve, do të përkrahet fuqishëm nga Qeveria e Republikës në krye me kryeministrin Kurti dhe presidenten e Republikës, Vjosa Osmani. Kam dhënë direktivën për ngritjen e task-forcës së FSK-së dhe gatishmërinë e tij, dhe me dhënien e autorizimit zyrtar nga ana e komandantes supreme të Forcave të Armatosura, presidentes Osmani, tani kontingjenti i FSK-së është nisur drejt zonave të prekura për angazhim në operacion në kuadër të forcave reaguese të Republikës së Shqipërisë", ka shkruar Mehaj në profilin e vet në "Facebook". Edhe ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka treguar për mobilizimin e trupave që ky institucion ka bërë. "Republika e Shqipërisë po përballet me problematikën e zjarreve tash e disa ditë. Natyrisht se ndihma ndaj njëritjetrit në situata të tilla është e

domosdoshme. Prandaj, sot si ministër i MPB-së kam kërkuar një mobilizim urgjent të ekipeve të zjarrfikësve, si përgjigje ndaj kërkesës urgjente të autoriteteve shqiptare për ndihmë dhe mbështetje të autoriteteve lokale të Kukësit për luftimin e zjarreve. Qendra Operative e MPB-së, në bashkëpunim me atë të AME-së, kanë përgatitur trupat për dislokim në Republikën e Shqipërisë, konkretisht në Qarkun e Kukësit për

mbështetjen e autoriteteve vendore për luftimin e zjarreve", ka shkruar Sveçla, duke shtuar se do të jenë përherë përkrah njëri-tjetrit për tejkalimin e sfidave të përbashkëta.

Shqipëria falënderon Kosovën për mbështetjen

Autoritetet më të larta të Shqipërisë kanë falënderuar Kosovën për mbështetjen për tejkalimin e kësaj sfide.



Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka bërë me dije se angazhimi i këtyre trupave ka pasur efekt për vënien në kontroll të disa vatrave të zjarreve. “Tuneli i Kalimashit plotësisht i kalueshëm dhe i sigurt. Falënderim për angazhimin operacional të strukturave zjarrfikëse të Kukësit dhe të Kosovës. Ndërsa vazhdon puna për ta mbrojtur tunelin, sot në orët e para të mëngjesit pritet një operacion me më shumë forca për t’i fikur zjarret në të gjithë malin e Rrunjës, për t’i mbrojtur jetët njerëzore dhe banesat e Shëmrisë”, ka shkruar Meta në profilin e vet në “Facebook”. Edhe lideri i PD-së, Lulzim Basha, ka falënderuar Kosovën për ndihmën vëllazërore në betejën me zjarret. “Mirënjohje Kosovës për ndihmën vëllazërore në betejën me zjarret! Bashkëpunimi me forcat ushtarake dhe civile të Shqipërisë, që prej ditësh po

sakrifikojnë me vetëmohim e në kushtet më të rënda, është jetik për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve dhe të pasurive natyrore. Faleminderit Kosovë për ndihmën dhe solidaritetin që nuk e ke kursyer kurrë!”, ka shkruar ai në profilin e vet në “Facebook”.

Kurse ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Niko Peleshi, ka shkruar në profilin e vet në “Facebook”, se Kosova po e ndihmon Shqipërinë me vepra. “Punë heroike e zjarrfikësve, Forcave të Armatosura dhe pushtetit vendor. Mirënjohje. Falënderim edhe për mbështetjen e trupave nga Kosova që kanë filluar angazhimin sot te Laku i Thive, Njësia Administrative Malzi”, ka shkruar ai.

Që nga fundi i muajit korrik Shqipëria është duke u përballur me vatra zjarri në pjesë të ndryshme të vendit. Drejtori i Rendit Publik në Policinë e Shtetit, Ylli Vasili, ka treguar se

Ahmeti: Besoj se institucionet e kanë kuptuar rëndësinë e punës së zjarrfikësve

Njohësi i çështjeve të emergjencave dhe drejtori ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë, Tahir Ahmeti, ka komentuar ndihmën që FSK-ja dhe zjarrfikësit e Kosovës i kanë dhënë Shqipërisë për shuarjen e zjarreve. Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se beson që institucionet e Kosovës e kanë kuptuar rolin dhe rëndësinë e punës që bëjnë zjarrfikësit. “Besoj dhe shpresoj që institucionet e Kosovës e kanë kuptuar rolin dhe rëndësinë e punës që bëjnë zjarrfikësit. Me

urgjencë do të fillojnë investimet e duhura në këtë sektor të sigurisë të lënë totalisht pas dore. Si pikënisje do të ishte përmirësimi i kushteve të punës si dhe mjeteve dhe pajisjeve të zjarrfikësve në mënyrë që ata të kryejnë punën e vet në shërbim të sigurisë së qytetarëve”, ka shkruar Ahmeti.

Ai ka vlerësuar se zjarrfikësit e Kosovës treguan edhe një herë që krahas punës profesionale që bëjnë, kanë edhe një profesion human. “Shqetësuese ishin pamjet e zjarreve të djeshme në zonën e Kalimashit në Shqipëri.

Përtej simbolikës, institucionet emergjente të Kosovës si gjithmonë menjëherë i dolën në ndihmë shtetit shqiptar. Ndihmë profesionale dhanë 33 zjarrfikës me 10 automjete për luftimin e zjarreve malore, si dhe një kontingjent i FSK-së për shuarjen e zjarreve. Zjarrfikësit e Kosovës treguan edhe një herë që, krahas punës profesionale që bëjnë, kanë edhe një profesion krejtësisht human dhe janë gjithmonë në shërbim të sigurisë së qytetarëve jo vetëm në Kosovë, por aty ku ka nevojë dhe aty ku u kërkohet”, ka shkruar Ahmeti.

nga 25 korriku deri më tani janë arrestuar 15 persona nën dyshimin për zjarrvënie të

qëllimshme. Gjendja më problematike me zjarre është në Thirrë të Mirditës, në

Karaburun, ku rrezikohet Parku i Llogorasë, dhe vatra sipër tunelit të Kalimashit.



Kurti takohet me shefin e Kryqit të Kuq në Kosovë, flasin për personat e zhdukur gjatë luftës

PRISHTINË, 10 GUSHT (ER) - Kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim shefin e Kryqit të Kuq, Agim Gashi, ku temë kryesore ishte çështja e personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Kurti e ka falënderuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për përkrahjen e vazhdueshme dhënë Qeverisë së Kosovës, në veçanti për mbështetjen e familjeve të personave të pagjetur. Kryeministri Kurti ka ritheksuar përkushtimin e qeverisë për avancimin e politikave

institucionale përmes të cilave do të ketë trajtim meritore për familjet e të zhdukurve me dhunë, duke pasur prioritet ndriçimin e fatit dhe vendndodhjes së të pagjeturve dhe vendosjen e drejtësisë.

Mes çështjeve të diskutuara në këtë takim ishte edhe databaza e shqiptarëve të arrestuar në Serbi si dhe domosdoshmëria e bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për reformën e burgjeve në Kosovë.



Në spitalin rajonal të Pejës vdes një i burgosur

PRISHTINË, 10 GUSHT (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar se të martën rreth orës 10:50 në spitalin rajonal të Pejës ka ndërruar jetë i burgosuri R. Sh., viti i lindjes 1937. I burgosuri ka qenë i shtrirë në Stacionarin e Burgut tërë kohën si pasojë e sëmundjeve të rënda kronike të zemrës, mushkërive,

sëmundjeve neurologjike, të prostatës, fytit, si dhe pamjaftueshmërisë së veshkave, sëmundje këto me të cilat ka ardhur në burg në fillim të vitit 2018.

Si pasojë e sëmundjeve dhe moshës, gjendja e tij ka qenë duke u përkeqësuar në vazhdimësi, ndërsa sot, para se


të nisej për hemodializë, gjendja e tij nuk ka qenë stabile, me urdhëresë të mjekut kujdestar, me urgjencë është dërguar në spitalin rajonal të Pejës, nën përcjellje të stafit mjekësor dhe me autoambulancë.

Pavarësisht prej përpjekjeve të vazhdueshme të stafit të burg, gjatë transportit e edhe në

spitalin rajonal në Pejë i burgosuri ka ndërruar jetë.

I njëjti është një ndër rastet për të cilët është kërkuar ndërprerja e dënimit për shkaqe shëndetësore, por nuk është aprovuar kjo kërkesë.

Gjatë kësaj periudhe është vaksinuar me të dyja vaksinat kundër Covidit.



Përkujtohen heronjtë Bedri Shala e Bekim Berisha-Abeja



DRENAS, 10 GUSHT (ER) - Me rastin e 23-vjetorit të rënies heroike të Bedri Shalës e Bekim Berishës-Abeja, kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, së bashku me kryesuesin e Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, drejtorë të Drejtorive komunale, anëtarë të Kuvendit dhe familjarë të heronjve, kanë bërë homazhe në përkujtim dhe nderim të jetës dhe veprës së tyre. Me këtë rast, ata kanë vendosur buqeta me lule pranë shtatores së heroit Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci" në Drenas dhe në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë. Me këtë rast, kryetari Lladrovci ka thënë se sot kujtojmë me nderim heronjtë e kombit të betejës së Junikut, Bekim Berisha, Bedri Shala, Përmet Vula, Elton Zherka dhe Bashkim Leku. "Në përvjetorin e kësaj beteje dhe rënies në altarin e lirisë, kujtojmë me nderim të thellë heronjtë e kombit të cilët iu bashkuan UÇK-së nga mërgimi dhe nuk u zbrapsën nga sulmet e ushtrisë okupatore deri në flijim", ka thënë Lladrovci.

Haziri: 163 familje gjilanase i kemi bërë me kulm mbi kokë

GJILAN, 10 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka deklaruar se i kanë bërë me shtëpi 163 familje të cilat kishin probleme të banimit. Sipas Hazirit, kjo është bërë në bashkëpunim me njerëzit e vullnetit të mirë të cilët jetojnë në mërgatë e në Kosovë.

"163 familjet gjilanase sot jetojnë me dinjitet, pasi më parë nuk kishin kulm mbi kokë. Ky ka qenë projekti i përzemërt i imi, pasi nuk kam mundur të jetoj në Gjilan, duke e ditur që dikush s'ka kulm mbi kokë. Faleminderit deri në gjuhëzim donatorëve, kryesisht

bashkatdhetarëve tanë, për shpirtin human dhe besimin ndaj programit tonë për familjen", ka thënë Haziri. Deri më sot në Gjilan janë ndërtuar 163 shtëpi për familjet në nevojë, kurse kostoja totale llogaritet të jetë afro 2.4 milionë euro.



Asfaltohet fusha e sportit në Shkozë të Malishevës

MALISHEVË, 10 GUSHT (ER) - Në fshatin Shkozë të komunës së Malishevës të martën është shtuar me asfalt fusha e sportit në oborrin e shkollës e cilado të jetë në funksion të shkollës dhe të rinjve të fshatit. Asfaltimin e fushës e kaparë nga afër edhe nënkryetari i komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili është pritur edhe nga kryetari i fshatit dhe drejtori i

shkollës. "Ndërtimi i kësaj fushe ka qenë pak i vështirë për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe përbërjes së tokës, por pas shumë përpjekjeve dhe punës së madhe që është bërë, më në fund kemi mbërritur ta finalizojmë dhe tani mbetet edhe rregullimi i rrethojës dhe vijëzimi i fushës. Nxënësit dhe të rinjtë e fshatit tani me fillimin e vitit të ri shkollor do ta kenë edhe

fushën e sportit. Qëllimi ynë është jo vetëm krijimi i kushteve sa më të mira për shkollën, në këtë rast për zhvillimin e orës së edukatës fizike, por edhe nxitja e të rinjve për t'u marrë me sport. Krejt investimet që kemi bërë në përgjithësi për sportin, janë shpërblyer me rezultate të mira nga klubet dhe të rinjtë tanë", ka thënë nënkryetari Berisha.



Murati: Regjistrimi i popullsisë i vitit 2022 do të jetë më cilësor dhe më i sigurt

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 GUSHT- Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka mbajtur debat publik lidhur me Projektligjin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë. Nga ky debat u tha se regjistrimi i popullsisë ndikon që të kemi një pasqyrë më gjithëpërfshirëse për përgatitjen e planeve strategjike që ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve.

Ministri i Punës, Financave dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se projekti i regjistrimit të popullsisë 2022 do të jetë më cilësor dhe më i besueshëm. Murati ka theksuar se regjistrimi i popullsisë është projekt i rëndësishëm nacional që mundëson të adresohen drejt sfidat dhe objektivat që do të ndikojnë në krijimin e një shteti zhvillimor dhe funksional përballë nevojave të qytetarëve të vendit. "Regjistrimi i popullsisë i vitit 2022 do të mbulojë edhe një boshllëk me të dhënat, duke krijuar kështu një bazë solide për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e një game të gjerë të politikave publike të cilat do të kenë ndikimin e drejtpërdrejtë në mirëqenie e qytetarëve tanë. Me zhvillimet e fundit përgatitore, pritjet janë që ky regjistrim i popullsisë të jetë më cilësor sesa ai i vitit 2011. Kemi ndryshim edhe sa i përket numrit të pyetjeve, por besoj se edhe sistemi dhe teknologjia e monitorimit që do të aplikohen



do ta kenë ndikimin e vet pozitiv", ka thënë ministri Murati.

Zëvendëskryeministrja për Çështje të Pakicave dhe të Drejtave të Njeriut, Emilija Rexhepi, ka thënë se si ekzekutiv janë të interesuar për këtë projekt meqenëse vitet e fundit është rritur migrimi në Kosovë, ndonëse pandemia ka stagnuar, por nuk dihen të dhënat. Ajo ka shprehur gatishmërinë për projektin e regjistrimit të popullsisë derisa ka kërkuar përfaqësim edhe për komunitetet pakicë në vend. "Ne si qeveri kryesisht jemi të

interesuar për këtë projekt, meqë migrimi i popullsisë kohët e fundit është në një nivel më të lartë. Kuptohet se pandemia Covid e ka ndërprerë këtë proces, por nuk kemi të dhëna të sakta për numrin e gjithë qytetarëve tanë. Në kufijtë e mundësive të mia do ta jap kontributin tim për këtë temë të rëndësishme dhe besoj se edhe ekspertët e bashkësive etnike që janë pakicë do të jenë të përfaqësuar", ka thënë ajo.

Drejtori ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Ilir Berisha, ka thënë se qëllimi kryesor i regjistrimit të

popullsisë është të sigurojë fakte thelbësore për politikëbërjen dhe administrimin në nivelin qendror dhe lokal. "Qëllimi kryesor i regjistrimit të popullsisë është të sigurojë fakte thelbësore për politikëbërje, planifikim dhe administrim në nivel qendror dhe lokal. Gjithashtu, një qëllim në vete është, përveç statistikës, të mundësojë edhe krijimin e kornizës së mostrave, të cilat mundësojnë zgjedhjen e mostrave për realizimin e anketave të shumta për hulumtime të çështjeve të ndryshme, si ai për fuqi

punëtore, i standardit jetësor dhe i migracionit", ka thënë Berisha.

Menaxheri i regjistrimit të popullsisë në ASK, Avni Kastrati, ka theksuar se formularët për projektin e regjistrimit të popullsisë janë më të zgjeruara krahasuar me atë të vitit 2011. Ai ka thënë se këtij projekti të rëndësishëm do t'i paraprijë një fushatë intensive. "Formularët janë zgjeruar pak krahasuar me vitin 2011, pasi 9 për qind më shumë ka pyetje thelbësore dhe 12 për qind pyetje jothelbësore", ka thënë Kastrati.

Vuçiq: Njohja e Kosovës nga Izraeli ishte zhgënjyese për Serbinë



BEOGRAD, 10 GUSHT- Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se njohja e shtetësisë së Kosovës nga Izraeli ka qenë zhgënjyese për Serbinë. Vuçiqi ka thënë të martën (10 gusht) se gjatë bisedës telefonike me presidentin e ri të Izraelit, Isaac Herzog, ka shfaqur shpresën se Serbia dhe udhëheqësia e re izraelite do t'i përparojnë raportet dypalëshe. "Presidenti Vuçiq ka shfaqur pritjen se presidenti Herzog dhe Izraeli do të vazhdojnë ta mbështetin dialogun Beograd - Prishtinë, i cili për Serbinë është mënyra e vetme e zgjidhjes së çështjes së ndjeshme të Kosovës", thuhet në komunikatën e presidencës serbe pas bisedës telefonike. Kosova dhe Izraeli kanë vendosur marrëdhënie diplomatike më 1 shkurt 2021. Njohja e ndërsjellë mes këtyre dy

vendeve ishte pjesë e marrëveshjes për normalizimin ekonomik të arritur në Uashington të ShBA-së më 4 shtator 2020.

Marrëveshja e Uashingtonit ishte nënshkruar atëbotë nga kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në prani të ish-presidentit amerikan Donald Trump.

Marrëveshja, gjithashtu, parashihte që Kosova ta hapë ambasadën në Jerusalem, ndërsa Serbia ta zhvendoste nga Tel-Avivi në Jerusalem.

Kosova e ka hapur ambasadën e saj në Jerusalem, ndërsa Serbia ende nuk e ka zhvendosur të veten. Sipas komunikatës, gjatë bisedës telefonike me presidentin e Izraelit, Vuçiq ka thënë se diskutimet do të kontribuojnë në

një mirëkuptim më të madh mes dy vendeve. "Ne e vlerësojmë si shumë të rëndësishme që Serbia dhe Izraeli, përmes bashkëpunimit, të kontribuojnë për zgjidhjen politike dhe paqësore të të gjitha mosmarrëveshjeve, konflikteve dhe çështjeve të hapura", ka thënë Vuçiq.

Siç thuhet, Izraeli është një nga investitorët më të rëndësishëm në Serbi dhe këto investime përfshijnë fushën e transportit dhe atë të pasurive të paluajtshme.

Të dy presidentët, sipas njoftimit, deklaruan se ka hapësirë për ta zgjeruar bashkëpunimin, përfshirë rritjen e nivelit të tregtisë, dhe se hapja e zyrës përfaqësuese të Odës Ekonomike Serbe në Izraeli ka dhënë shtysë këtij qëllimi.

ATK-ja mban tryezë diskutimi për subvencionimin e masave nga pakoja për ringjallje ekonomike

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 10 GUSHT- Duke pasur parasysh se institucioni i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) është implementues i disa prej masave të pakos për ringjallje ekonomike dhe duke ditur që komuniteti i bizneseve është indikator i rëndësishëm për zbatimin e kësaj pakoje, drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, të martën ka mbajtur tryezë diskutimi me përfaqësuesit e odave ekonomike dhe shoqatat e kontabilitetit, lidhur me ecurinë e masave: 1.1, 1.2, 1.3 të kësaj pakoje, të cilat ATK-ja ka përgjegjësi të implementimit. Gjatë këtij diskutimi, drejtori Murtezaj ka kërkuar nga komuniteti i bizneseve dhe shoqatat e kontabilitetit që ta përkrahin ATK-në për

kanalizimin e informacionit të grupet e atakuara të cilat mund të përfitojnë nga këto masa. Po ashtu, u fol edhe për mënyrën e aplikimit për subvencionimin e masës 1.1 për të cilën ATK-ja ka krijuar veglën përmes platformës EDI, e cila shërben për t'i verifikuar personat që kualifikohen apo jo për subvencionim nga masa 1.1. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e bizneseve dhe shoqatave të kontabilitetit thanë se do të bashkëpunojnë në mënyrë që anëtarët e tyre të jenë të njoftuar në kohë reale me procedurat e subvencionimit të kësaj pakoje. Në pikën 1 për Mbështetjen e Punësimit nga Pakon për Ringjallje Ekonomike janë ndarë 50 milionë euro për krijimin e vendeve të reja të punës, duke mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë punëkërkesit.



Ndërkaq pika 1.1 parasheh rikthimin në punë të atyre që kanë humbur vendet e punës gjatë pandemisë, për të cilën

masë janë paraparë 10 milionë euro, më pas pika 1.2 mbështetja për të punësuarit e formalizuar me 10 milionë euro,

si dhe pika 1.3 mbështetja e punësimit të grave me 5 milionë euro. Pjesa tjetër e masave nuk është përgjegjësi e ATK-së.

Ministrja Hajdari merr vendim që të hetohet importi i blloqeve nga Serbia



PRISHTINË, 10 GUSHT (ER)- Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka bërë me dije se ka hapur rrugë që të bëhet hetim zyrtar në lidhje me importimin e blloqeve nga Serbia në Kosovë. Ajo në një konferencë për media ka thënë se janë analizuar çmimet e shitjes së blloqeve me pakicë dhe janë bërë hetimet preliminare ku komisioni përkatës ka rekomanduar hapjen e hetimeve. “Unë më 9 gusht si ministre kam marrë vendim për hapjen e hetimit zyrtar për blloqet nga Serbia”, ka bërë me dije Hajdari. Këto hetime, siç sqaroi ajo, janë bërë gjatë vizitave të kompanive që bëjnë shitjen e blloqeve të importuara nga Serbia. “Duke analizuar këtë sektor para dhe pas shfuqizimit të masës mbrojtëse antidamping, të dhënat e dala nga hulumtimi preliminar i bërë nga Departamenti i Tregtisë në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe dhe takimit

me Shoqatën e Prodhuesve të Materialit Ndërtimor nga Argjila, tregojnë për një tendencë të dëmtimit të prodhimit vendor nga produktet e importuara nga Serbia në drejtim të çmimeve dumping”, thuhet në vendimin e ministres. Më tutje, thuhet se “duke u bazuar në Ligjin për Masat Antidamping dhe Masat Kundër Balancuese, përkatësisht nenit 28, Departamenti i Tregtisë, në konsultim me Komisionin e Detyrimeve të Veçanta për Importe, rekomandon marrjen e vendimit për hapjen e hetimit zyrtar për importin e blloqeve standarde me dimensione 19x19x25 nga Serbia, me dyshimet se një importi i tillë i blloqeve të importuara nga Serbia në Kosovë po vazhdon të shitet me çmime më të ulëta se çmimi i tyre në tregun e brendshëm në Serbi dhe rrjedhimisht një import i tillë rrezikon prodhimin vendor për shkak të çmimeve joreale”, thuhet në vendim.

Rukiqi takohet me nënkryetarin e Odës Ekonomike të Izraelit, zotohen për bashkëpunim

PRISHTINË, 10 GUSHT- Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka takuar të martën nënkryetarin e Odës Ekonomike të Izraelit, Roy Roznek. Pas takimit, kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka thënë se qëllimi i

këtij takimi është mundësia e rritjes së bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Izraelit në shumë fusha. Derisa ka bërë me dije se në tetor do të qëndrojë në Izrael për vizitë, Rukiqi ka thënë se të dyja odat do të angazhohen për

krijimin e kushteve ligjore duke iniciuar edhe një marrëveshje për tregti të lirë në mes të dy vendeve. Në anën tjetër, Roznek ka theksuar se kjo është vizita e parë e tij në Kosovë, me qëllimin e vetëm që dy shtetet

ta nisin thellimin e bashkëpunimit. “Është kënaqësi të jem këtu për herë të parë. Ky takim është një lidhje e fortë ekonomike në mes të dy shteteve dhe për këtë arsye jam këtu”, ka thënë Roznek.





Si mund ta dëmtojnë ekonominë, plagët psikologjike të shkaktuara nga Covid-19

Nga Ryan BOURNE

“CapX”

Cila do të jetë trashëgimia ekonomike e kësaj pandemie? FMN beson se PBB-ja e SHBA-së do të jetë më e madhe deri në fund të vitit 2022, sesa ishte parashikuar në vitin 2019. Pra me fjalë të tjera, nuk do të ketë një ndikim të vazhdueshëm të trazirave të këtij viti në prodhimin amerikan.

Natyrisht, Zyra për Përgjegjësinë e Buxhetit, është akoma pesimiste: Supozimi i saj kryesor është se PBB-ja do të jetë 3 për qind më e ulët në planin afatmesëm. Fakti që po shohim parashikime të tilla kontradiktore është jo i papritur, duke pasur parasysh pasigurinë. Performanca e PBB-së amerikane, do të varet pjesërisht nga politikat makroekonomike, por gjithashtu edhe nga një mori të panjohurash. Si do të ndikojnë tek industria zakonet e shpenzimeve të konsumatorëve, dhe mënyrat e reja të punës? Sa ngjitëse do të dëshmohet tëjete zgjerimi i qeverisë, dhe çfarë do të thotë kjo për normat e taksave?

Cili do të jetë efekti afatgjatë i shkollimit të humbur në kapitalin njerëzor dhe produktivitetin?

Por ka edhe një gjë tjetër që po i shqetëson ekonomistët, dhe mund t'i lërë në hije faktorët e tjerë të lart-përmendur:

një “traumë psikologjike” e mundshme.

Të gjithë shqetësohemi në shkallë të ndryshme mbi rreziqe të pazakonta, sikurse janë pandemitë. Por si njerëz, ne biem shpesh pre e një “paragjykimi të disponueshmërisë”, duke i dhënë një peshë më të madhe mundësisë së ngjarjeve që kujtohen më lehtë.

Nëse jetesa përmes Covid-19, do të na nxitë të rishikojmë parashikimet tona mbi efektet e goditjeve ekstremisht negative si pandemitë, atëherë investimet e rrezikshme mund të bëhen më pak tërheqëse, duke e zvogëluar përfundimisht prodhimin.

A ka të ngjarë të ndodhë kjo? Ju mund ta keni imagjinuar lehtësisht këtë vitin e kaluar, duke i bërë ndërmarrësit e ardhshëm të ngurrojnë të investojnë kursimet e tyre të jetës në industri siargëtimi apo turizmi.

Edhe nëse politikanët nuk përfshihen në riatdhesimin e detyruar të zinxhirëve të furnizimit sikurse kanë kërcënuar të bëjnë, kujtesa e mundësisë së një pandemie të re, do të sjellë padyshim zhvendosjen e shumë kompanive nga “optimizmi” i zinxhirëve të tyre të furnizimit, tek të menduarit për rezistencën në rastin e një goditjeje.

Por sikur të bëhemi tepër të frikësuar ndaj rrezikut? Unë kam miq që megjithëse janë vaksinuar plotësisht, refuzojnë të hanë në ambiente të mbyllura me të tjerët. Shumë amerikanë të arsimuar dhe të vaksinuar, mbajnë ende maska kur janë

plotësisht vetëm në ambiente të jashtme, pavarësisht udhëzimeve të qeverisë që e minimizojnë nevojën e tyre.

Ky fobi e madhe ndaj rrezikut ekstrem, nuk zbutet dot nga një media amerikane, e cila sipas analizave nga profesori i ekonomisë i Kolegjit Dartmouth, Brus Saçerdot, prodhon histori jashtëzakonisht negative në pandemi, edhe kur ka lajme të mira për të ardhmen.

Kur rastet e reja me Covid-19 po binin në SHBA, Saçerdot zbuloi se media këtu do ta vinte gjithnjë e në shumë theksin tek numri i madh i vdekjeve. Edhe kur vaksinat po shpërndahen masivisht, mediat flasin për rrezikun e varianteve të reja, efekteve anësore apo për paralajmërimet e tjera.

Në kushtet kur pasojat negative janë amplifikuar kaq shumë, nuk është e vështirë të imagjinohet se popullatat e tronditura psikologjikisht, kanë frikë nga pandemitë e ardhshme, dhe ndoshta mund të jenë tepër paranojake edhe për ngjarje me probabilitet më të ulët apo me rrezik të lartë, qofshin këto pasojat ekstreme nga ndryshimi i klimës, asteroidet ose shpërthimet vullkanike.

Në fakt historia sugjeron që ne duhet të jemi skeptikë ndaj shpalljeve fataliste. Në librin e tij më të fundit “Katastrofa”, historiani Niall Ferguson shpjegon se një tipar i jashtëzakonshëm i katastrofës, është se sa shpejt njerëzit i rikthehen normalitetit.

Perandoria Romake mbeti kryesisht e palëkundur nga shpërthimi i Vezuivit. Gripi

spanjoll la pak ndikime të dukshme, përveç numrit tronditës të vdekjeve. Në fakt, një studim nga ekonomistët Natalia Fuentes dhe Isabella Moder mbi ndikimin e ngjarjeve të tjera ekzogjene të tilla si epidemitë, luftërat e mëdha ose goditjet e çmimit të naftës, ka zbuluar se asnjëra prej tyre nuk duket se sjell një rënie të vazhdueshme të PBB-së, të paktën pas disa viteve.

Sigurisht, kjo qëndron në kontrast të plotë me ndikimet e recesioneve ‘endogjene’, siç janë krizat financiare. Njerëzit i rikthehet me shpejtësi normalitetit. Por ndryshe nga epidemitë e mëparshme, Covid-19 ka shkaktuar një frikë më të madhe për më shumë se një vit.

Një studim nga ekonomistja Ulrike Malmendier, ka zbuluar se kushtet e pafavorshme makroekonomike në fillim të jetës, mund të kenë efekte afatgjata te njerëzit, veçanërisht në rritjen e frikës ndaj rrezikut financiar.

Kjo pandemi ishte një zile zgjimi për shumë njerëz, që ishin tepër të sinqertë në lidhje me rreziqet që lidhen me patogenët virale. Sipas Ferguson, pasja e disa Kasandrave në qeveri që paralajmërojnë për rreziqe të çuditshme, ndihmon jo pak.

Por nëse përvoja e pandemisë e bën shoqërinë më shumë se sa duhet të shqetësuar për katastrofën, atëherë pasojat e plagëve të kësaj krize, do të jenë shumë më të mëdha sesa kemi menduar deri më tani. / bota.al



Mendimi krijues – Auguste Rodin dhe ‘Mendimtari’

Nga Joe MCGASCO

Në çdo epokë të artit, gjenden punime të cilat i tejkalojnë sferat e koleksionuesve të artit dhe të frekuentuesve të muzeve, duke kapur imagjinatën e publikut. Vepra si Mona Lisa e Da Vinci-t, Britma e Edvard Munch, ose Nata me yje e Van Gogh, kapërcejnë kohën dhe vendndodhjen duke u kthyer në standarde kulturore, kaq të afërta me konceptet tona të artit, saqë me kalimin e kohës, bëhen objekt i parodive dhe komercializimit (a dëshiron ndokush një qese me Van Gogh-un?). Numri i veprave të artit që kanë këtë lloj ndikimi është i pakët, por, një nga më të mirënjohurat dhe më të vlerësuarat, është një skulpturë e një francezi me emrin Auguste Rodin, i cili, në fund të shekullit të 19-të, krijoi një ikonë, të cilën e quajti Le Penseur. Këtë e njohim me emrin Mendimtari dhe shumë prej nesh, mund të krijojnë një imazh në mendje, pa parë asnjë foto të tij. Ndryshe nga shumica e

skulpturave që njihen menjëherë nga publiku, Mendimtari nuk është një statujë e madhe patriotike si Statuja e Lirisë në New York, ose statuja e Krishtit Shpëtimtar që qëndron mbi Rio de Janeiro. Krijuar me një madhësi modeste dhe bazuar mbi një temë reflektimi, në vend të një ngjarje të shënuar apo përkujtimi, Mendimtari përçon një ide të cilën mund ta rrokim të gjithë – nevojën për analizë të heshtur – por e paraqet në një mënyrë aq të qartë, saqë e bën këtë proces të brendshëm të duket fizikisht i prekshëm. Portretizimi i fortë i aktit të thjeshtë të të menduarit, e ka bërë po aq të njohur sa veprat e tjera të mëdha publike dhe qëndron (më saktë, ulet) si një vepër e denjë në radhët e kryeveprave nga Da Vinci, Munch dhe Van Gogh që u përmendën më sipër. Po si u krijua kjo skulpturë me famë botërore? Biografite e sotme trajtojnë historinë pas krijimit të Mendimtarit, një vepër e cila, me thjeshtësinë e paraqitjes, forcën e krijimit dhe hijen e misterit,

vazhdon të ketë ndikim te njerëzit, edhe 100 vjet pas krijimit.

Krijimi i emrit të tij

Duke marrë parasysh famën që arriti në fund, ditët e hershme të François Auguste René Rodin si artist, kanë qenë të paqëndrueshme dhe të vështira. Ndërsa iu refuzua tri herë pranimit në shkollën më të mirënjohur të artit, École des Beaux-Arts, Rodin ushtroi talentet e tij artistike duke bërë punë dekorative për shtëpi dhe ndërtesa publike. I pakënaqur nga ana artistike prej kësaj pune me pagesë, për të pasuruar biografinë e tij, ai punoi si asistent i skulptorit Albert-Ernest Carrier-Belleuse, duke ndjekur njëkohësisht, leksione mbi skulpturën. Një udhëtim në Itali, në mesin e viteve 1870 (kur ishte në të tridhjetat) forcoi vendosmërinë e Rodin për t'u bërë skulptor, ndërsa shihte për herë të parë nga afër, veprat e Michelangelo-s. Puna e tij e parë serioze, Epoka

e bronzit (I mposhturi), u përfundua shpejt, pas këtij udhëtimi. Një bronz kaq real, saqë kritikët e akuzuan Rodin se thjesht i kishte dhënë formën një bronzi të vërtetë. Kjo vepër tregoi provën e parë të një stili të përparuar. Një vepër realiste, themelore dhe paksa e paqartë në qëllimin e saj. Në fund të viteve 1870, ndërsa punonte për Carrier-Belleuse në fabrikën e porcelanit Sèvres në Belgjikë, Rodin u prezantua me disa zyrtarë të lartë të qeverisë franceze, të cilët, e njihnin reputacionin e tij për punë të shkëlqyera dekorative. Edhe pse më përpara nuk pati sukses për të siguruar punë nga qeveria, Rodin nisi të merrte dhe të pranonte punë për monumente dhe skulptura publike. Më e rëndësishmja prej tyre, iu dha në vitin 1880: një portë e madhe për një muze të propozuar të arteve dekorative në Paris. Musée des Arts Décoratifs nuk do të ndërtohej kurrë (aty tani qëndron Musée d'Orsay), por kjo vepër do të nxiste krijimin e shumë veprave të mëpasshme

nga Rodin, të cilat, jo vetëm do të çonin në krijimin e Mendimtarit, por do të përcaktonin rrugën e gjithë karrierës së tij.

Portat e Ferrit

Idenë për portën e tij të re, Rodin e bazoi në Komedinë Hyjnore të Dantes, e cila, në fund të shekullit të 19-të, kishte rifiturar popullaritetin. Rodin interesohej të përshtaste personazhe nga libri i parë i Komedisë Hyjnore, Ferri, në mënyrë që të kishte një kontrast karshi dyerve të famshme prej bronzi të Pagëzimores së Firences, të krijuara nga Lorenzo Ghiberti, të cilave, Michelangelo, u referohej si Portat e Parajsës. Krijimin e tij, Rodin e quajti Portat e Ferrit. Plani i Rodin përmbante vendosjen e një figure qendrore e cila të përfaqësonte Danten, mbi portën 6 metra të lartë. Kjo figurë do të dominonte ndodhitë nga libri, të ilustruara përreth kornizës së portës. Për këtë arsye, skulptura e cila në fund do të bëhej Mendimtari, u quajti fillimisht Le Poète (Poeti),

për t'iu referuar Dantes.

Rodin e mori projektin me entuziazëm të madh dhe versionet e hershme të shumë skulpturave, të cilat u krijuan për të qenë pjesë e Portave të Ferrit, lanë mbresa si te kritikët, ashtu dhe te koleksionistët. Nuk kaloi shumë kohë para se pjesë individuale të projektit, të hiqeshin me kërkesën e blerësve të interesuar. Le Poète ishte nga të parat. Në vitin 1884, Rodin gdhendi për një koleksionues nga Anglia, një version më të hershëm të statujës, duke i vendosur një kapele të stilit të Firences, një ndryshim ky, nga konceptimi original i personazhit si Dante. Megjithatë, Rodin tashmë kishte vendosur se kthimi i këtij poeti në një person tjetër, nuk ishte drejtimi që dëshironte të ndiqte. Prandaj, ai vendosi t'ia hiqte rrobat, përfshi kapelën, ndërsa vazhdonte ta gdhendte dhe të krijonte personazhe të tjerë. "Thatanik, asketik e me mantelin e tij, Dantja im, i ndarë nga ansambli, nuk do të kishte asnjë kuptim," deklaroi ai. Si rrjedhojë, Le Poète u bë Le Penseur. "Konceptova një tjetër mendimtar, një burrë lakuriq të kërrusur mbi një shkëmb, me gishtat e këmbëve të mbledhura e të vendosura pas tij. Me grushtin të ngjeshur pas dhëmbëve, ai mendon. Mendimi kreativ zhvillohet dalëngadalë në trurin e tij. Ai nuk është më një ëndërrimtar, por një krijues."

I përfunduar plotësisht

Versionet e hershme të statujës nuk u shfaqën asnjëherë. Më në fund, në vitin 1888 në Kopenhagen, Rodin vendosi ta shfaqte punën e tij përpara publikut, në formën që përfaqësonte më së miri, idenë universale që tashmë ai përfytyronte. Statuja prej allçie, më pak se një metër e lartë, tregonte një burrë të panjohur, të zhytur në mendime, një njeri të zakonshëm, fiziku i fuqishëm i të cilit, shërbente për të shprehur një ndjenjë gjithë përfshirëse. "Ajo çfarë e bën mendimtarin tim të mendojë, është se ai nuk mendon vetëm me trurin, vetullat e rrudhura, flegrat e zgjeruara dhe buzët e mbledhura," thekson Rodin, "por me çdo muskul në krahët e tij, kurrizin dhe këmbët, me grushtin dhe gishtat e mbledhura të këmbëve." Statuja nuk tregonte më qëndrimin e një poeti mbi një grumbull trillimesh letrare; ajo shprehte një moment analize të vetvetes të çdo qenie njerëzore – një poeti, udhëheqësi, akademiku, punëtori të zakonshëm, ose edhe të vetë artistit.

Me shfaqjen në Paris në Galerie Georges Petit, Mendimtarit u prit



kaq mirë në këtë formë të zvogëluar, sa që Rodin vendosi të krijonte një version më monumental. Duke përdorur një proces të zhvilluar në vitet 1830, i cili gjurmonte punën e një artisti në shkallë më të vogël për të krijuar një kopje më të madhe, ai dhe asistenti i tij, Henri LeBossé, me ndërrimin e shekullit, krijuan gradualisht, statujën 1.8 metra të lartë, prej allçie dhe të lyer në ngjyrë bronzi, e cila është bërë e njohur si versioni më i arrirë. Ky version qëllimthi më i ashpër e më madhështor, u shfaq në vitin 1904 në Sallonin e Pranverës në Paris. Në këtë madhësi, skulptura rrezatonte padyshim më shumë pushtet dhe forcë sesa në versionin më të vogël, sikur problemet që rëndonin mbi këtë burrë të ishin më të thella, ose, sikur sapo të përfundonte së menduari, do të ngrihej e të përballej me to.

Një reagim shpërthyes

Reagimi ndaj Mendimtarit ishte kaq i fortë, sa që ideja e shitjes të një blerës privat, trazoi kritikun francez të artit, Gabriel Mourey. Ai nisi një fushatë të suksesshme për blerjen e statujës për popullin francez, kështu që i gjithë kombi ta zotëronte. Në vitin 1904, kur u shfaq edhe versioni i bronzit në Panairin Botëror Shën Luis, Mendimtarit u vendos përpara Panteonit në Paris, mauzoleu ku qëndrojnë eshtrat e qytetarëve të mëdhenj francezë dhe një nga ndërtesat me rëndësinë më të madhe simbolike në qytet. Megjithatë, për herë të parë nga disa raste gjatë viteve, statuja do të provokonte një reagim të papritur. Kishte vetëm një muaj e

gjysmë që ishte ekspozuar, kur një burrë me të meta mendore, i quajtur Poitron, në 16 janar 1905, e shkatërroi statujën, duke shpjeguar pas arrestimit, se i dukej sikur kjo statujë po e tallte. I paprekur nga ky incident i një kritike ekstreme ndaj artit, Rodin dhe stafi i tij, krijuan një model tjetër të statujës, këtë herë prej bronzi, e cila u vendos përpara Panteonit në vitin 1906. Këtë herë, perceptimi i Rodin për këtë vepër kishte evoluar. Ai e shihte tani si një nderim për popullin francez, një monument publik me një funksion publik: "Lartëson mendimin e atyre njerëzve modestë të kombit që janë sidoqoftë, krijues energjish të fuqishme. Është në vetvete një simbol shoqëror." Mendimtarit do të qëndronte përpara Panteonit deri në vitin 1922, kur perceptimi i tij si një simbol socialist, nisi të rëndonte mbi elementët më konservativë të Francës dhe solli si rrjedhojë, zhvendosjen e tij. (Ky version i statujës u zhvendos te Musée Rodin, një muze, i krijuar nga punishtja e Rodin, pak kohë pas vdekjes së tij.)

Një numër i madh mendimtarësh

Mendimtarit, së bashku me pjesë të tjera të marra nga Portat e Ferrit, si statuja e famshme që quhet Puthja, e kthyen Rodin në një yll të artit. Një statujë e mëparshme dhe e papërsosur e poetit Balzac, u zëvendësua me aprovimin e gjerë që mori Mendimtarit. Dëshira për këtë statujë gjatë jetës së tij ishte kaq e madhe, sa që Rodin aprovoi 10 modele të skulpturës prej bronzi, për institucione të ndryshme.

Përveç versioneve që u shfaqën në Panairin Botëror të Shën Luisit, të tjera statuja prej bronzi u shfaqën në Londër, Laipzig, Berlin, Dresden, Kopenhagen, Stokholm, Venecia dhe Poznan, Poloni. Një statujë monumentale e Mendimtarit mbërriti në Amerikë për t'u mbajtur aty, kur Legjioni i Nderit në San Francisco, bleu njërin nga kopjet europiane në vitin 1915.

Një nga skulpturat e fundit monumentale të Mendimtarit, të aprovuara nga Rodin, u ble nga Muzeu i Artit në Cleveland, në vitin 1916. Si një jehonë e fatit të statujës origjinale në vitin 1905 në Paris, ky version i skulpturës u shpërthye me dinamit në vitin 1970, siç supozohet, prej anëtarëve të grupit revolucionar radikal The Weather Underground (asnjë nuk u arrestua në lidhje me këtë krim). Pjesa e poshtme e këmbëve dhe bazamenti i statujës u dëmtuan tej mase, por në një përpjekje për të ruajtur sa më mirë gjendjen e mëparshme (dhe, në fakt, për të reflektuar ndjenjat e Rodin se si aksidentet mund të cilësojnë artin), statuja u rivendos në gjendjen e dëmtuar dhe qëndron edhe sot, aty. Është një version mbresëlënës i statujës, shkëmbi poshtë këtij burri, i përhapur si petale të përthyer, ndërsa mendimet e tij qëndrojnë të patrazuara. Statuja duket njëkohësisht më moderne dhe në mënyrë klasike, më e copëtuar.

Një ikonë e pavdekshme

Auguste Rodin vdiq në vitin 1917. Popullariteti i Mendimtarit, gjatë jetës së tij, ishte një burim

kënaqësie për të dhe rëndësia që kishte për të personalisht, u konfirmua nga fakti që kërkoi një kopje të kësaj statuje, të vendosë mbi varrin e tij dhe varrin e gruas, Rose Beuret, në shtëpinë e tyre në Meudon. Gruaja e tij vdiq në shkurt të vitit 1917 dhe pas saj në nëntor, në moshën 77 vjeçare, edhe Rodin. Le Penseur qëndron i menduar mbi varret e tyre, ndoshta tani, për çështje që lidhen më shumë me parajsën, sesa me botën. Në fakt, ndryshe nga çdo kopje tjetër e statujës, në piedestalen e vendosur në Meudon, është gdhendur emri "RODIN", duke e bërë të qartë lidhjen ndërmjet burrit në skulpturë dhe krijuesit të tij. Statuja shërben si përmendore dhe si komentuar.

Kohët ndryshojnë dhe për një periudhë gjatë shekullit të 20-të, pas vdekjes së tij, veprat e Rodin e humbën popullaritetin; megjithatë, Mendimtarit, nuk e humbi asnjëherë. Në 100 vitet që kanë kaluar nga vdekja e Rodin, kjo statujë është krijuar gati njëzetë herë dhe tani mund të shihet në shumë vende të botës. Vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, versione të kësaj statuje gjenden në Baltimore (në dy vende), New York (edhe këtu në dy vende), Cleveland, Denver, Detroit, Louisville, Pasadena, Kansas City, Houston dhe Philadelphia (si pjesë e një muzeu që i kushtohet posaçërisht veprave të Rodin). Këto vepra monumentale, siç Rodin synonte, qëndrojnë zakonisht në ambiente të hapura, në mënyrë që skulptura të bëhet pjesë e ambientit, e ekspozuar ndaj elementëve të jashtëm, por njëkohësisht e mbyllur në vetvete. Sigurisht, popullariteti i Mendimtarit shkon përtej shfaqjeve fizike; me kalimin e kohës, është bërë një emblemë në kulturën pop. Është satirizuar në filmat vizatimorë (seria e karikaturave komike Kikirikët e paraqiste në mënyrë të paharrueshme), është parodizuar në skenë, në filma dhe në emisione televizive, madje, edhe është përdorur nga një kompani sigurimesh për t'i shtuar një hije serioziteti, broçkullave të policave të sigurimit. Ndërsa të gjithë këto tallen me natyrën serioze të veprës, asnjë prej tyre nuk sfidon frymën thelbësore të saj, e cila, duket e paprekshme nga satira. Kjo vepër është një ikonë sepse është e fuqishme dhe kjo fuqi, që nga momenti i krijimit, nuk i është dobësuar asnjëherë. Ruan një hije misteri të cilën asnjë satirë nga kultura pop nuk mund ta penetrojë. Edhe tani, ne ende e shohim këtë kryevepër të Rodin dhe pyesim veten se ç'po mendon ky Mendimtar.

/exlibris.al/

Përktheu David Hudhri

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina transferon Betim Halimin

PRISHTINË, 10 GUSHT (ER)- Portieri gjigant, 25-vjeçari Betim Halimi, pas përvojës disavjeçare në futbollin ndërkombëtar, gjegjësisht në atë estonez dhe ukrainas, duke shënuar ngritje të madhe në cilësi dhe performancë, kthehet te kampioni aktual i Kosovës, FC Prishtina, për tre vjetet e ardhshëm. "Pritshmëritë personale, konsideroj se në aspektin personal dhe profesional janë në ngritje të vazhdueshme. Me punë dhe përkushtim këto rezultate do të jenë kulminante. Pritshmëritë me klubin, fillimisht më duhet të them se të qenit pjesë e FC Prishtinës është privilegj i veçantë, njëkohësisht edhe përgjegjësi e madhe, sepse Prishtina është skuadër me renome në nivelin



vendor dhe ndërkombëtar. Kjo po kulminante që i ka arritur edhe kontributi im nga sot e tutje do të jetë i madh, pasi ka tri deri në

pesë vjet që po zhvilloj aktivitetet në nivelin ndërkombëtar, me rezultate dhe paraqitje shumë të mira dhe të njëjtat rezultate shpresoj t'i kem edhe me Prishtinën", ka thënë Halimi, duke shtuar se pret rezultate kulminante në kampionatin vendor dhe në garat ndërkombëtare. "Prishtina është simbol i qytetërimit dhe është kryeqyteti i shtetit tonë të dashur. Sa iu përket tifozëve, janë ata të cilët na japin emocion dhe kurajë për rezultate kulminante. Tifozët e Prishtinës, 'Plisat', janë të njohur në tifoskenën vendore dhe ndërkombëtare për spektakle dhe koreografi të cilat u japin emocion të veçantë lojtarëve dhe publikut, emocione që edhe unë tani e tutje do t'i përjetoj", ka thënë Betim Halimi.

Hiqen të gjithë posterët e Messit përreth Camp Nou

BARCELONË, 10 GUSHT- Barcelona ka filluar të mendojë jetën pa Lionel Messin, që tashmë është duke u përgatitur të kalojë te Paris Saint-Germaini. Ylli argjentinasi mbajti të dielën në mesditë një konferencë lamtumriëse derisa lotët i rrodhën që po largohej pas 21 vjetësh qëndrim. Lojtari 34-vjeçar tashmë është në bisedime me PSG-në dhe pritet që brenda kësaj jave të kalojë në Parkun e Princave. Por, klubi katalunas ka filluar t'i heqë të gjithë posterët në të

cilët gjendej ylli argjentinasi. Barcelona po bëhet gati për edicionin e ri dhe është normale që një largim i tillë i posterëve të ndodhë. Largimi i gjashtë herë fituesit të Topit të Artë u pranua me shumë pikëllim nga përkrahësit e Barcelonës që nuk e kishin pritur një gjë të tillë. Messi kishte pranuar vazhdimin e kontratës me katalunasit, mirëpo kushtet financiare dhe rregullat e La Ligës nuk lejuan që ai të vazhdonte më tej.



Real Madridi merr veprime juridike ndaj presidentit të La Ligës



MADRID, 10 GUSHT-Real Madridi nuk është duke u pajtuar me disa vendime të ndërmarrë nga presidenti i La Ligës, Javier Tebas. Përmes një njoftimi për media, Los Blancos ka njoftuar se do të ndjekë rrugët ligjore që Tebas dhe zyrtarët e tjerë të penalizohen. "Në takimin e tij

sot në orën 11.00 të mëngjesit (CEST), bordi i drejtorëve i Real Madrid CF u pajtua njëzëri për të filluar veprime juridike civile dhe penale kundër presidentit të La Ligës, Javier Tebas Medrano, Javier de Jaime Guijarro, kreu i Fondit CVC dhe kundër vetë fondit CVC Capital

Partners SICAV-FIS. Për më tepër, bordi i drejtorëve ka vendosur të ndërmarrë çdo veprim ligjor që ai e konsideron të përshtatshëm për të anuluar dhe për të bërë joefektive çdo rezolutë të mundshme të miratuar nga Asambleja e La Ligës, që do të

mbahet më 12 gusht 2021, në lidhje me marrëveshjen midis La Ligës dhe CVC Fondit", thuhet në njoftimin e Real Madridit. Ende nuk është sqaruar se përse klubi madrilen do t'i ndjekë këto rrugë juridike kundër Javier Tebas dhe stafit të tij.

Zyrtarizohet marrëveshja e sponsorizimit të Ligës së Parë

PRISHTINË, 10 GUSHT (ER)- Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe pronari i kompanisë "Viva Fresh", Xhevdet Rexhepi, e zyrtarizuan marrëveshjen për sponsorizimin e

Ligës së Parë. Nga kjo kontratë e lidhur ndërmjet FFK-së dhe kompanisë "Viva Fresh" do të përfitojnë 20 klubet e Ligës së Parë të të dyja grupeve. Në bazë të

marrëveshjes së arritur palët u pajtuan që Liga e Parë në edicionin e ri garues të quhet "Viva Fresh Liga e Parë". Kampionati i ri në "Viva Fresh Ligën e Parë" fillon më 28 gusht.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 10.08.2021 bënë anulimin e shpallje publike për dhënie të pronës së paluajtshme me qira.

NJOFTIM PËR ANULIM

Duke u bazuar në shpalljen publike T-21-001- rishpallje të datës 24.04.2021 e publikuar në gazetën Epoka e re anulohet dhënia e kontratës për Llotin 11

Duke u bazuar në shpalljen publike T-21-001 të datës 26.03.2021 e publikuar në gazetën Epoka e re anulohet dhënia e kontratës për Llotin 35.

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 të Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021.

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|------------------------------------|---------------------|-------------------------------|
| Emri zyrtarë: Trepça sh.a. | | |
| Adresa postare: Parku inustrial | | |
| Qyteti: Mitrovicë | Kodi postarë: 40000 | Shteti: Kosovë |
| Kontakti: Burim HAJDINI | | Telefoni: +383 (0) 28 538 050 |
| Email: sales@trepcacorporation.com | | Faksi: +383 (0) 28 539 202 |
| www.trepcacorporation.com | | |



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA

N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
FERIZAJ
Nr. 120 Data 10.08.2021



Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A.

FERIZAJ

Kryeshefi Ekzekutiv i Stacioni Autobusëve Sh.a.Ferizaj në bazë të nenit 16 pika 1 të Statutit të kompanisë, Ligjit të Punës nr.03.L-212 neni 8 dhe 10 pika 2.2 Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Organogramin, lidhur me plotësimin e vendit të punës, rishpallë:

KONKURS

ME KOHË TË CAKTUAR I VJET ME MUNDËSI VAZHDIMI

Për vendin e punës.

(1) SPIKER/ E – BILETAR/E

Kualifikimet e nevojshme:

Kërkesën dhe CV

13. Shkolla e mesme

14. Aftësi për të punuar në mënyr të pavarura dhe si pjesë e ekipit

15. Shkathësi të shkëlqyeshëm komunikues

16. Shkathësi të shkëlqyeshëm për kompjuter (Certifikatën nga ndonji institucion kredibil).

17. Përovja e punës është e dëshirueshme

18. Dëshmi se nuk është nën hetime

Vlerësimi dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim

Lartësia e pagës përcaktohet në harmoni me politikat e Kompanisë

Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionin në zyrat e kompanisë N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A në Ferizaj dhe po në të njëjtin vend edhe mund të dorëzojnë aplikacionet.

Dokumentacioni i pa kompletuar nuk do të konsiderohet të vlefshëm. Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë, pas seleksionimit të dokumentacionit të paraqitur nga komisioni përkatës.

Afati për dorëzimin e aplikacionit është 8 ditë nga dita e publikimit të konkursit prej orës 8:00 - 16 :00.

Ferizaj, 10.08.2021

Kryeshefja Ekzekutive



Albulenë Çalaj

A. Çalaj

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejite

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Shehrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.A.P " Hynsi Zajmi" Gjakovë

► Petrit Lluhani shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► "DEPO STEEL" Sh.p.k. me adresë në Bresje -4, Fushë Kosovë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: NUI 810545171.

► Fjolla Duraku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjmnazit "Hajdar Dushi".

► Qëndrim Grezda nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjmnazit "Hajdar Dushi"

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

